

*shpallur me 29.01.2020*  
*pefuzurimit me 18.02.2020*



Në bazë të nenit 113 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr 02/18, 034/19) dhe Vendimit mbi shpalljen e konkursit publik, numër 01-031/20-673 të datës 23.01.2020, Sekretariati për vetëqeverisje lokale- Zyra për burime njerëzore, s h p a l l

## KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

### 1. Sekretari/ja e Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik të komunës së Tuzit

- Ekzekutues: 1, në kohëzgjatje të caktuar, person i cili kryen punët e kuadrit të lartë drejtues emërohet në periudhë prej 5 (pesë) vitesh
- niveli i VIII i kualifikimit të arsimit,
- Fakulteti ekonomik
- provimin profesional për punë në organet shtetërore
- Më së paku tri vite përvoj pune në punet drejtuese ose tetë vite përvojë pune në punë të njëjta ose të ngjajshme
- Njohja e punës në kompjuter
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze.

### Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes në vend pune të lirë (Formulari i paraqitjes në vend pune të lirë kandidatët mund të nxjerrin në sajtin e komunës së Tuzit, [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) ose drejtpërdrejtë në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diploma ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit,
- vërtetimi i gjyqjit kompetent që kundër kandidatit/tes nuk zhvillon procedurë penale sipas detyrës zyrtare,
- dëshmi (vërtetim) mbi përvojën e punës së kërkuar,
- vërtetim mbi provimin profesional të dhënë për punë në organet shtetërore.

Kandidatët mund të dorëzojnë kopjet e dokumentacionit të lartpërmendur, përderisa origjinalet janë të obliguar të dorëzojnë zyrtarit të Zyrës për zbatimin e konkursit.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh marrëdhënie pune personi i cili është shfrytëzues i të drejtës në pension, në përputhje me ligj.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili ka realizuar të drejtë në dëmshpërblim nuk mund të lidh marrëdhënie pune në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhë prej një viti nga dita e pagesës së dëmshpërblimit. Kufizimi nuk zbatohet për person që kthen të gjithë shumën e dëmshpërblimit të paguar.

Verifikimi i kompetencave, njohurive dhe aftësive të kandidatëve për plotësimin e vendit të punës nga kategoria e kuadrit të lartë drejtues do të zbatohet në përputhje me nenin 121 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr.02/18, 034/19).

Verifikimi i kompetencave, njohurive dhe aftësive të kandidatëve nënkupton hartimin e punimit me shkrim, i cili përfshin shqyrtimin e prioriteteve dhe propozimeve për avancimin e procesit të punës, përkatësisht situatën në fushën e punës për të cilën kandidati emërohet.

Kandidati i cili ka realizuar më shumë se 50% të pikëve në testin në formë të shkruar, mund të qaset intervistës së strukturuar.

Mbi datën, vendin, kohën dhe mënyrën e verifikimit, kandidatët nga lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit publik do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 20 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

### **Komuna e Tuzit**

#### **Sekretariati për vetëqeverisje lokale- Zyra për burime njerëzore**

**Me shënim: për Konkurs publik- emertimi i vendit të punës në të cilin kandidati paraqitet**

Kontakt tel: +38220875167;

**U.D. SEKRETARE**  
Marina Ujkaj

